



Pranuar / Dorezuar Primi/Prodato Received/Delivered	22.05.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHTOK	4367/2023		117



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.556/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.556/2023 të datës 24.03.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër Vendimit me DM 73/2023 të datës 27.02.2023 të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore në Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në çështjen juridike "transfer", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 22.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.556/2023 e datës 24.03.2023 e parashtruar nga ankuesi *ndërsa* lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek Komisioni i Ristrukturimit.

II. Anullohet Raporti i Punës 04/2023 i Komisionit të Ristrukturimit lidhur me procedurën e transferimit në pozitën "Menaxher i ZR Mitrovicë në Departamentit e Koordinimit Rajonal dhe Operativës" si dhe të gjitha aktet dhe veprimet e tjera juridike që rrjedhin prej tij.

III. Shfuqizohet Memorandumi i Brendshëm i datës 16.02.2023 dhe Vendimi për transferimin e ankuesit i datës 27.02.2023 të nxjerra nga Departamenti i Burimeve Njerëzore.

IV. Detyrohet Komisioni i Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarr veprimet juridike në pajtim me legjislacionin në fuqi.

V. Obligohet Drejtori Menaxhues i Agjencisë Kosovare të Privatizimit që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën IV.

VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



## Ar sy e t i m

Ankuesi sipas shkresave të lëndës i punësuar në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (*tutje AKP*), me datë 24.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me numër protokoli:2962/2023 nën shenjë A.nr.556/2023, kundër Vendimit DM 73/2023 të datës 27.02.2023 të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se me rastin e zhvillimit të procedurës së transferimit kanë bërë shkelje të dispozitave të Udhëzuesit Nr.02/2022 për Procesin e Riorganizimit të Institucioneve Publike dhe Sistematizimin e Nëpunësve pas Ristrukturimit, shkeljeve të dispozitave të ligjit material dhe konstatim të gabuar gjendjes faktike, ndërsa ankuesi me datë 28.04.2023 ka bërë plotësimin e ankesës me pretendimet ankimore se institucioni punëdhënës me rastin e transferimit të nëpunësve civil për shkak të ristrukturimit të institucionit në pozitat e punës: Kryesues i Njesisë së Marketingut dhe tenderit Publik, Kryesues i Njesisë për Kontrata në Departamentin e Shitjes, Kryesues i Njesisë për Negocim Direkt dhe Menaxher i Zyrës Rajonale të AKP-së në Mitrovicë, ka transferuar nëpunësit në kundërshtim me dispozitat e Rregullores për Transferimin e Nëpunësve Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, më datë 30.03.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ndërsa Këshilli më datë 24.04.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 2962/2023 e datës 24.03.2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të parashtruar nga ankuesi; E-mail i dërguar nga L.XH drejtuar V.H e datës 23.12.2022; E-mail i dërguar nga BURIMET Njerëzore drejtuar V.H e datës 15.02.2023; Memorandum i brendshëm i datës 16.02.2023; Vendim me numër DM 73/2023 i datës 27.02.2023; E-mail i dërguar nga L.XH drejtuar V.H e datës 14.03.2023; Tabela për sistemimin e pikëzimit për vlerësimin e performancës, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për ankuesin; E-mail i dërguar nga V.H drejtuar L.XH e datës 20.03.2023; E-mail i dërguar nga V.H drejtuar Burimeve Njerëzore e datës 20.01.2023; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 30.03.2023; Përgjigja në ankesë e datës 24.04.2023; Vendim me nr.ref. BD-171/61 e datës 31.10.2023; Mendim këshillimor me nr.prot.2340 e datës 15.11.2022; Vendim me nr.ref.BD-173/3 E DATËS 30.11.2022; Organogram i datës 25.04.2019; Organogram i datës nëntor 2022; Akt emërim i datës 28.12.2022; Kushtet e punës; Vendim me numër DM 1118/2022 i datës 14.12.2022; Vendim me numër DM37/2023 i datës 14.02.2023; Tabela për sistemimin e pikëzimit për vlerësimin e performancës, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për B.B; Tabela për sistemimin e pikëzimit për vlerësimin e performancës, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për F.M; Tabela për sistemimin e pikëzimit për vlerësimin e performancës, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për D.B; Tabela për sistemimin e pikëzimit për vlerësimin e performancës, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për N.K; Tabela për sistemimin e pikëzimit për vlerësimin e performancës, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për A.K; Tabela për vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil; Tabela e poentimit për trajnime; E-mail i dërguar nga V.H drejtuar L.XH e datës 16.02.2023; Pëlqimi për pranimin e pozitës së ofruar i datës 16.02.2023; E-mail i dërguar nga V.H drejtuar L.XH e datës 09.03.2023; E-mail i dërguar nga L.XH e datës V.H e datës 14.03.2023;



E-mail dërguar nga V.H drejtuar A.H e datës 20.03.2023; Kontratë punë e datës 23.12.2009; Kërkesë e datës 11.11.2009 Kontratë pune e datës 30.12.2008; Aneks Kontrate e datë 01.04.2009; kërkesë e datës 24.12.2008; Kontratë punë e datës 29.10.2008; Përshkrim i detyrave të punës Akt emërim i datës 30.07.2014; Shtojcë- Kushtet e punës; Akt emërim i datës 21.11.2018; Shtojcë- Kushtet e punës; Akt emërim i datës 29.12.2022; Shtojcë- Kushtet e punës; Kontratë pune e datës 30.11.2007; Aneks kontrate e datës 19.09.2007; Aneks kontrate e datës 29.05.2007; Kontratë pune e datës 08.12.2006; Shtojce e kontratës; Shtojce e kontratës; Kontratë e punës e datës 02.12.2005; Kontratë e punës e datës 15.12.2005; Kontratë e punës e datës 01.01.2005; Shtojce e kontratës; Kontratë pune për staf lokal e datës 21.06.2004; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës me numër 9 e datës 15.01.2001; Diplomë e lëshuar nga Universiteti "Hasan Prishtina" me numër 424 e datës 22.09.2022; Certifikatë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës me nr. M11066/09 e datës 22.10.2012; Formular për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësit civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 16.01.2023; Formular për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësit civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 31.01.2022; Formulari për përcaktimin e objektivave të punës i datës 31.01.2022; Plani individual i trajnimit i datës 31.01.2022; Certifikatë e lëshuar nga USAID për periudhën Janar-Dhjetor 2006; Certifikatë e lëshuar nga USAID për periudhën Prill-Qershor 2007; Certifikatë e lëshuar nga Universiteti i Londrës i datës 31.12.2009; Certifikatë e lëshuar nga USAID për periudhën Prill-Qershor 2006; Certifikatë e lëshuar nga Eorld Learning dhe USAID; Certifikatë e lëshuar nga USAID për periudhën janar-shkurt 2006; Certifikatë e lëshuar nga USAID për periudhën mars- prill 2006; Certifikatë e lëshuar nga USAID për periudhën Qershor- Korrik 2006; Certifikatë e lëshuar nga USAID për periudhën Shtator-Tetor 2006; Certifikatë e lëshuar nga USAID për periudhën Tetot-Nëntor 2006; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e datës 26.04.2016; Certifikatë e lëshuar nga Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit apo të Internuarit të UCK-së; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike e datës shtator 2022; Zarf e bardhë; Plotësim ankese e datës 28.04.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e *bazuar*, sepse:

Kolegji i Këshillit nga analizim i shkresave të lëndës ka gjetur se Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit me Vendimin me Nr.Ref.BD-173/3 të datës 30.11.2022 ka aprovuar Rregulloren Nr. 07/2022 për Organizmin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe si rezultat i kësaj ka pasur shuarje dhe ndryshime në përshkrimin e vendeve të punës të disa pozitive, ndërsa përmes Vendimit DM 1118/2022 të datës 14.12.2022 Drejtori i Departamentit të Burimeve Njerëzore ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për shqyrtimin e mundësisë së sistemimit të çdo nëpunësi civil si pasojë e miratimit të Rregullores se re, kurse sipas Vendimin DM37/2023 të datës 14.02.2023 të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore është ndryshuar Vendimi DM 1118/2022 i datës 14.12.2022 lidhur me ndryshimin e njërës nga anëtarët e Komisionit të Ristrukturimit.

Drejtorja e Burimeve Njerëzore më datë 23.12.2022 e ka njoftuar ankuesin që me rastin e miratimit të Rregullores Nr.07/2022 për Organizmin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, është shuar Departamenti i Marketingut, Marrëdhënie me Publikun dhe Investitorët, si rrjedhojë është shuar edhe pozita e punës "Kryesues i Njesisë për Marrëdhënie me Publikun" të cilën ankuesi ka qenë duke e ushtruar sipas Akt Emërimit me numër



reference:155/DMMPI8 të datës 29.12.2022, duke e njoftuar që Komisioni i Ristrukturimit konform dispozitave ligjore në fuqi do të trajtojë mundësin e sistemimit në një pozitë të lirë ekzistuese.

Nga shkresat e administruara të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se për pozitën *“Menaxher i ZR Mitrovicë në Departamentit e Koordinimit Rajonal dhe Operativës”* e cila ka qenë e lirë dhe për të njëjtën pozitë ankuesi ka qenë në procedurë të transferimit me pesë (5) kandidatë të tjerë, nëpunës civil të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ndërsa Komisioni i Ristrukturimit pas analizimit të dokumenteve që dëshmojnë vjetërsinë e nëpunësit civil, rezultateve në punë, kualifikimeve profesionale dhe trajnimeve, ankuesin e ka vlerësuar me (48) pikë, dhe mbi këtë bazë ka hartuar Raportin e Punës me shifër 04/2023 përmes të cilit konstatohet se ankuesi është renditur kandidati i dytë (2) kurse kandidatja B.B rezulton si kandidatja që ka grumbulluar më së shumti pikë (50.5), rrjedhimisht rezulton që është kandidatë potenciale që mund të transferohet apo emërohet në pozitën *“Menaxher i ZR Mitrovicë në Departamentit e Koordinimit Rajonal dhe Operativës”*.

Më pas ankuesi me datë 14.02.2023 është ftuar për takim me Komisionin e Ristrukturimit për datën 15.02.2023, ndërsa Drejtoria e Burimeve Njerëzore me datë 16.02.2023 pas pëlqimit të dhënë të ankuesit përmes e-mailit të datës 16.02.2023, nxjerr shkresën *“Memorandum i Brendshëm”* përmes të cilët konstatohet se ankuesi do transferohet në pozitën *“Zyrtar i lartë i Shitjes Direkte”* shkresë të cilën ankuesi e nënshkruan pa vërejte me datë 27.02.2023, mirëpo në përmbajtjen e saj evidentohet fakti se institucionin punëdhënës lënë të kuptojë se ankuesi meqenëse nuk ka arritur të grumbulloi pikë për tu emëruar në pozitën e lartcekur ekuivalente pasi që pozita që mbante ishte shuar, i njëjti mund të kalojë në listën e stafit tepriçë, ndërsa institucionin punëdhënës ka vullnetin që të njëjtit t’i ofrojë një pozitë e cila është e lirë por me e ulët sesa pozita që ankuesi ishte duke e ushtruar. Tutje, Drejtoria e Burimeve Njerëzore me datë 27.02.2023 nxjerr vendimin me shifër DM-73/2023 përmes të cilit ankuesin transferon në pozitën *“Zyrtar i Lartë i Shitjes Direkte”*, ndërsa në pikën II të dispozitivit përcaktohet se transferimi do të realizohet me datë 01.06.2023.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar dispozitat e nenit 54 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *“1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi civil shuhet, ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori; 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet një komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozitë të lirë, në të cilën ai i plotëson kërkesat e veçanta. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia e pranimit, në bazë të propozimit të komisionit”* ndërlidhur me nenin 14 paragrafi 4 të Rregullores (QRK)-Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë ku përcaktohet se: *“Komisioni në propozimin e tij për transferimin e nëpunësve civilë për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit mbështetet në kriteret specifike të vendeve të lira apo të atyre të krijuara dhe kualifikimet dhe të dhënat e nëpunësve civilë. Vendimi është individual për çdo nëpunës civil.”*, dhe ka ardhur në përfundimin se Komisioni i Ristrukturimit me rastin e hartimit të Raportit të Punës me shifër 04/2023 përmes të cilit ishte konstatuar poentimi i gjashtë (6) kandidatëve potencial për transferim në pozitën *“Menaxher i ZR Mitrovicë në Departamentit e Koordinimit Rajonal dhe Operativës”*, është vepruar në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 54 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 14 paragrafi 4 të Rregullores (QRK)-Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, ngase Raporti i Punës me shifër 04/2023 nuk përmban elemente të shqyrtimit lidhur me përshkrimin e detyrave të punës për këtë pozitë dhe as kualifikimet e nevojshme që kandidatët potencial duhet t’i plotësojnë për tu transferuar, respektivisht për tu emëruar në këtë pozitë me rastin e mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, pasi që fillimisht për pozitën e lirë duhet të jenë të aprovuara përshkrimi i detyrave të punës dhe kërkesave të veçanta, me





theks në përvojën dhe kualifikimit profesionale të kërkuara, e më pastaj kandidatët në kushte të barabarta t'i nënshtrohen procedurës të cilën e udhëheqë Komisioni i Ristrukturimit duke i respektuar parimet e përcaktuara në nenin 14 paragrafi 5 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë ku përcaktohet se: *"Komisioni gjatë transferimit të nëpunësve civil për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit cakton prioritetin e transferimit dhe mbështetet mbi këto kritere: 5.1. vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil; 5.2. vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civilë ; 5.3. kualifikimet profesionale të nëpunësve civilë. 5.4. trajnimet"*, prandaj mbi këtë bazë për shkak të shkeljeve procedurale dhe materiale apo për shkak të mungesës së arsytimit të tij, Kolegji i Këshillit vlerëson se Raporti i Punës me shifër 04/2023 i Komisionit të Ristrukturimit është akt i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative sikurse përcaktohet se: *"1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.4 është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material"*.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson faktin se shkresa e datës 16.02.2023 e titulluar "Memorandum i Brendshëm" i hartuar nga Departamenti i Burimeve Njerëzore është nxjerrë në kundërshtim me frymën e legjislacionit material për shërbimin civil, ngase tek rasti i transferimeve të përhershme për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, proces i cili është i rregulluar me nenin 54 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, askund nuk përkufizohet termi listë apo staf tepricë dhe as nuk ekziston mundësia ligjore që një kandidat në procedurë të transferimit të cilit iu është shuar pozita e punës të transferohet në një pozitë më të ulët në kuadër të institucionit, pasi që kur shteren mundësitë që ankuesi të transferohet në një pozitë të së njëjtës kategori apo ekuivalente me pozitën që ka mbajtur fillimisht në kuadër të institucionit sipas nenit 54 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, 2.2 dhe 2.3 Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *"Transferimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar; 2.2. në institucionin në të cilin është bashkuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar"* atëherë hapet rrugë që nëpunësi civil të transferohet në një institucion tjetër të Shërbimit Civil në pozitë të së njëjtës kategori apo ekuivalente me pozitën që ka mbajtur sikurse përcaktohet me nenin nenit 54 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ndërlidhur edhe me nenin 13 paragrafi 2 të Rregulloren Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë ku përcaktohet se: *"Në rast se paraqiten rastet e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, nëpunësit civilë sistemohen në vendet e reja të krijuara, të ristrukturuar apo të mbetura si pasojë e ristrukturimit apo shuarjes së institucionit, në të njëjtën kategori, në njërin nga institucionet e përcaktuara në Nenin 54. paragrafin 2 të Ligjit"*, prandaj mbi këtë bazë veprimet e Departamentit të Burimeve Njerëzore përmes shkresës së datës 16.02.2023 "Memorandum i Brendshëm" rezultojnë që kanë tejkaluar kompetencat ligjore ngase nuk e ka autoritetin dhe as përgjegjësinë ligjore që të interpretojë apo ndryshojë dispozitat e aplikuara të ligjit material, duke e transferuar ankuesin në një pozitë të kategorisë më të ulët sesa pozitën që e ka ushtruar përmes aktit të emërimit, prandaj edhe në këtë rast shkresa "Memorandum i Brendshëm" e datës 16.02.2023 është akt i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative sikurse përcaktohet se: *"1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3 organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material dhe 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme"*, sikurse që është i paligjshëm edhe çdo akt tjetër administrativ apo veprim juridik që rrjedh prej tij, në këtë kuptim i kundërligjshëm është edhe Vendimi me shifër DM-73/2023 i lëshuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore me datë 27.02.2023 përmes të cilit ankuesi është transferuar në pozitën "Zyrtar i Lartë i Shitjes Direkte".





Prandaj, meqenëse Kolegji i Këshillit pas konstatimeve të dhëna si më lartë se zhvillimi i procedurës së transferimit për pozitën "Menaxher i ZR Mitrovicë në Departamentit e Koordinimit Rajonal dhe Operativës" është përcjellë me shkelje procedural dhe zbatim të gabuar të ligjit material nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, gjegjësisht Komisioni i Ristrukturimit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, dhe duke pasur parasysh se sipas nenit 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik nëpunësit e saj nuk e kanë statusin e veçantë, rrjedh se Agjencia Kosovare e Privatizimit në kuptim të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore, duke iu referua nenit 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: "Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paañsisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë" si dhe nenit 32 paragrafi 3 po të të njëjtit ligj me të cilin parashihet se: "3.Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligj" është e obliguar të zbatohet dispozitat e këtij ligji, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se procedura e transferimit për pozitën "Menaxher i ZR Mitrovicë në Departamentin e Koordinimit Rajonal dhe Operativës" duhet të kthehet në pikën fillestare, prandaj sikurse është përcaktuar si në dispozitiv të këtij vendimi, Raporti i Punës 04/2023 i Komisionit të Ristrukturimit lidhur me procedurën e transferimit në pozitën "Menaxher i ZR Mitrovicë në Departamentin e Koordinimit Rajonal dhe Operativës" do të anulohet si dhe të gjitha aktet dhe veprimet e tjera juridike që rrjedhin prej tij, ndërsa janë shfuqizuar shkresa "Memorandumi i Brendshëm" i datës 16.02.2023 dhe Vendimi për transferimin e ankuesit i datës 27.02.2023 të nxjerra nga Departamentit i Burimeve Njerëzore, ndërsa lënda është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje. Komisioni i Ristrukturimit me rastin e rishqyrtimit dhe rivendosjes së këtij rasti duhet të marrë parasysh pikëpamjet juridike të këtij vendimi.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson faktin se ankesa e ankuesit e datës 24.03.2023 është aprovuar si e bazuar për shkak të konstatimit nga ana e Kolegjit të Këshillit se Komisioni i Ristrukturimit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Agjencisë Kosovare të Privatizimit kanë bërë shkelje procedurale dhe kanë zbatuar gabimisht dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ndërsa aprovimi i kësaj ankese nuk nënkupton se ankuesi është dashur të transferohet në pozitën e kontestuar, pasi që në rastin konkret për shkak të shkeljeve të konstatuara si më lartë, Kolegji i Këshillit nuk është lëshuar në shqyrtim meritor lidhur me faktin nëse procesi i poentimit sipas kriterëve të përcaktuara ligjore ka qenë në rregull.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.556/2023

Flakron Gashi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Komisionit të Ristrukturimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së